

# E drejta e informimit 2022 – A po synohet të ngrihet një shkallë më lart?

Edhe këtë vit Res Publica, me mbështetjen e pakursye të National Endowment for Democracy, ka monitoruar zhvillimet në këtë fushë duke vijuar me testimin aktivisht të efektivitetit të ligjit, me fokus të veçantë në kërkimin e informacionit me sensitivitet të lartë, aty ku perceptohet se ka më shumë dobësi, të cilat përbëjnë shteg për zyrtarët që nuk dëshirojnë të japin informacionin e kërkuar. Aktiviteti kryesor gjatë këtij viti ka qenë procesi i konsultimit të ndryshimeve në ligjin për të drejtën e informimit, proces i iniciuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në fund të vitit 2021, i cili nuk ka përfunduar ende. Gjithashtu në këtë raport trajtohet edhe veprimtaria e Agjencisë për Media dhe Informim, e krijuar në vitin 2021, që synon të rregullojë marrëdhëniet publike të organeve të ekzekutivit, dhe ku një aspekt që trajtohet është edhe informimi i gazetarëve nga autoriteteve publike dhe konfuzioni që krijohet nga mpleksja e dy rregullimeve të ndryshme, sidomos për një gazetar të patrajnuar.

**Raportin e plotë mund ta shkarkoni duke klikuar këtu.**

Raporti prezanton rezultatet që kanë dalë nga përpunimi i të dhënave të marra nga platforma **Publeaks.al** për vitin 2022 dhe sjell shifra krahasuese me periudhat e mëparshme (vitet 2015-2021), për të shfaqur në mënyrë konkrete dhe vizive, përmes grafikëve, përmirësimin apo përkeqësimin e treguesve konkretë. Konkretisht, janë mbledhur dhe janë analizuar të dhënat si më poshtë:

a. Është monitoruar “transparenca proaktive” e 100 institucioneve publike më të rëndësishëm në vend, duke

vlerësuar programet e transparencës, duke vlerësuar plotësimin, përshtatjen dhe përditësimin e tyre.

b. Është monitoruar ngritja e kapaciteteve të nevojshme për të bërë të mundur funksionimin e detyrimeve të institucioneve për të përmbushur të drejtën e publikut për t'u informuar, në lidhje me caktimin e koordinatorëve dhe publikimi e përditësimi i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve.

c. Është testuar dhe vlerësuar reagimi i institucioneve, duke vlerësuar përmes kriterëve të matshme sjelljen e tyre ndaj kërkesave për informacion. Janë dërguar 243 kërkesa për informacion dhe është monitoruar e gjithë procedura administrative përkatëse. Kërkesat kanë nisur kryesisht përmes aplikimit në faqen Publeaks.al. Nga këto kërkesa janë përzgjedhur 212 , të cilat kanë ndjekur ciklin e plotë, duke ruajtur një numër të përshtatshëm për efekt krahasimi me vitet e mëparshme. Disa nga treguesit kryesorë të matshëm që janë marrë në konsideratë janë: (1) Kohëzgjatja e kthimit të përgjigjes; (2) Plotësia dhe saktësia e përgjigjes; (3) Reagimi i institucioneve pas ankimit administrativ.

d. Është monitoruar veprimtaria e Komisionerit për të Drejtën e Informimit, si autoriteti i krijuar posaçërisht nga ligji për të garantuar funksionimin e tij.

e. Nga të dhënat e mbledhura nga aplikimet në Publeaks.al, janë parë me interes edhe aspekte që kanë të bëjnë me motivimin e qytetarëve për t'u informuar, të tilla si moshë e aplikantëve, arsimit, gjinia, kategoria, objekti i kërkesave, etj.

f. Raporti trajton edhe aspekte të veçanta, si konsultimi publik lidhur me projektligjin për disa ndryshime në ligjin nr 119/2014 "Për të drejtën e Informimit"; veprimtaria e Agjencisë për Media dhe Informim në drejtim të mbivendosjes së kësaj verimtarie me organe të tjera të administratës; Anonimizimi i vendimeve të gjykatave; si dhe një vlerësim i

mbështetjes ligjore të ofruar nga Res Publica në çështje gjyqësore dhe evidentimi i problematikave të mbartura nga vitet e kaluara të cilat mbeten ende të pazgjidhura.

Res Publica

---

## **E drejta e informimit 2021**

Edhe për vitin 2021, Res Publica ka vijuar të monitorojë zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit. Raporti është pjesë e projektit të mbështetur nga National Endowment for Democracy, i cili konsiston në përmirësimin e lirisë së shprehjes dhe të drejtës së informimit të qytetarëve shqiptarë.

Viti 2021 solli disa zhvillime të reja, si: nënshkrimi i Konventës së Tromsø, krijimi i Agjencisë për Media dhe Informim, e kritikuar ashpër nga gazetarët, si dhe në fund të vitit u publikua edhe një draft për disa ndryshime në ligjin për të drejtën e informimit. Res Publica u fokusua në këto zhvillime pa lënë pas dore monitorimin e zakonshëm të punës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe të transparencës së institucioneve.

Raporti sjell shifra krahasuese me periudhat e mëparshme (vitet 2015-2020), për të shfaqur në mënyrë konkrete dhe vizive përmes grafikëve përmirësimin apo përkeqësimin e treguesve konkretë. Në përgjithësi vihet re se tashmë mund të thuhet me bindje që janë “normalizuar” standardet mediokre të zbatimit të ligjit, si dhe po hedhin rrënjë elemente të rinj dëmtues në praktikat e institucioneve. Gjykatat kanë vijuar të jenë pozitive në trajtimet e rasteve. Megjithëse raportet zyrtare e shtrembërojnë të vërtetën rreth zbatimit të ligjit,

Res Publica synon të sjellë një pamje tjetër, e cila mund t'i japë organeve politikbërëse sinjalet e duhura për nivelin e dobët dhe alarmant të zbatimit të së drejtës së informimit. Për me shumë mund të shkarkoni raportin e plotë, **duke klikuar ketu**.

---

## **E drejta e informimit 2020 – Informimi në kohë krize dhe problemet e tjera të zakonshme**

Edhe për vitin 2020, Res Publica ka vijuar të monitorojë zbatimin e te drejtes se informimit. Raporti eshte pjese e nje projekti te mbeshtetur nga National Endowment for Democracy, i cili konsiston ne permiresimin e lirise se shprehjes dhe te drejtes se informimit të qytetareve shqiptare.

Viti 2020 ishte nje vit i ngarkuar me probleme te nje natyre te pazakonte per shkak te pandemise se shkaktuar nga Covid19, dhe per kete arsye Res Publica u fokusua ne menyre te vecante ne standardet nderkombetare te zbatimit te te drejtes se informimit ne kohe krizash. Keshilli i Evropes u identifikua si organizmi qe ka prodhuar standardet me konkrete ne kete aspekt.

Megjithë problematiken e vecante, gjate 2020 nuk u la pas dore monitorimi i punes se Komisionerit per te Drejten e Informimit, si dhe pati disa risi qe vijne nga praktika e Gjykates Administrative.

Raporti sjell shifra krahasuese me periudhat e meparshme

(vitet 2015-2019), për të shfaqur në mënyrë konkrete dhe vizive përmes grafikeve përmirësimin apo përkeqësimin e treguesve konkretë. Në përgjithësi vihet re se po “normalizohen” standarde mediokre të zbatimit të ligjit, si dhe po hedhin rrenjë disa elemente të rinj demtues në praktikën e institucioneve. Gjykatat kanë qenë pozitive në trajtimet e rasteve, por Komisioneri për të Drejtën e Informimit nuk po funksionon sipas kërkesave të ligjit. Për më tepër, të dhënat e raporteve zyrtare shtremberojnë me shumë këte peizazh, duke bërë që organet politikeberese të mos kenë sinjalet e duhura për nivelin e dobët dhe alarmant të zbatimit të të drejtës së informimit. Këto, por edhe gjetje të tjera që flasin për problematikat e vecanta, janë bërë pjesë e studimit të plotë, të cilin mund ta shkarkoni këtu.

---

## **Indeksi i transparencës 2019**

Për herë të dytë, me mbështetjen bujare të Programit të Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci të Ambasadës së SH.B.A në Tiranë, Res Publica zhvilloi projektin “Rritja e aksesit të gazetarëve investigues në informacionin zyrtar”. Një prej komponentëve të këtij projekti synon të sjellë një tablo se si paraqitet transparenca e autoriteteve publike në mënyrë dinamike, në të dy aspektet, atë proaktive dhe atë reaktive.

Res Publica vijoi traditën duke monitoruar 100 autoritetet publike më të rëndësishëm në vend për përmbushjen e programeve të transparencës dhe vlerësoi gjithashtu edhe sjelljen e institucioneve në rastin e trajtimit të kërkesave për informacion të dërguara nga qytetarët, gazetarët, aktivistët, etj. Janë dërguar gjithsej 251 kërkesa për informacion, prej të cilave 76 janë nga gazetarët investigues.

Ky aspekt është i një rëndësie të veçantë sepse një institucion mund të publikojë shumë informacione pa kërkesë, por nga ana tjetër mund të mos përgjigjet ndaj kërkesave specifike, çka mund të minojë transparencën.

Vlerësimi u bë në mënyrë dinamike duke studiuar ndryshimet çdo muaj gjatë periudhës Nëntor 2018 – Shtator 2019. Rezultatet mujore janë publikuar ne faqen [www.publeaks.al](http://www.publeaks.al) dhe raporti i permbledhur pasqyron gjetjet kryesore të periudhës, shoqëruar me rekomandimet përkatëse. Për më shumë klikoni ketu per te shkarkuar raportin.

Res Publica

---

## Konsultimi publik në Shqipëri 2017-2018



Më 1 Prill 2019, Res Publica prezantoi raportin për zbatimin e ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” gjatë viteve 2017-2018. Raporti është pjesë e një projekti të mbështetur nga National Endowment for Democracy, i cili konsiston në monitorimin dhe vlerësimin e proceseve të konsultimit publik, përfshirë edhe një vlerësim të punës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit, si organ kujdestar i këtij ligji.

Ne qender të prezantimit u vu pyetja: A është konsultimi

publik ne Shqiperi nje ushtrim i çilter i demokracise pjesemarrrese apo thjesht nje fasade? Duke bere krahasime me konceptimin e ketij procesi ne vende te ndryshme te Evropes, raporti paraqet shifra per te kuptuar se deri ne cilen shkalle pjesemarrja e publikut ne proceset vendimmarrese eshte e mirepranuar nga qeveria. Ne thelb vihet re se konsultimi publik ne dy vitet e fundit nuk paraqet interes per qeverine, por edhe per vete publikun. Nje numer i madh draftesh nuk konsultohen fare, ndersa per nje pjese tjeter konsultimeve jane vetem fasade. Ne nje numer te vogel rastesh konsultimi ka qene i vlefshem per te dy palet, por numri i organizatave qe zakonisht angazhohen eshte i vogel, ndersa publiku i gjere nuk ka treguar interes. Regjistri elektronik i krijuar per te lehtesuar komunikimin e publikut me qeverine nuk eshte perdorur, jo vetem per shkak te apatise qytetare, por edhe per shkak te ideimit te gabuar te vete regjistrimit. Nje numer rekomandimesh jane listuar ne fund te raportit, me qellim adresimin e shqetesimeve te ngritura. Per t'u njohur me studimin e plote, klikoni ketu per ta shkarkuar.

---

**E drejta e informimit 2018 –  
Informacioni i vonuar është  
informacion i mohuar**

# E DREJTA E INFORMIMIT 2018



Informacioni  
i vonuar  
është  
informacion  
i mohuar

Më 28 Janar 2019, Res Publica prezantoi raportin për të drejtën e informimit gjatë vitit 2018. Raporti është pjesë e një projekti të mbështetur nga Civil Rights Defenders, me fonde të Mbreterisë së Suedisë, i cili konsiston në mundësimin e qytetarëve të aksesojnë informacionet publike, si dhe në berjen e një vlerësimi të punës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit.

Një kermill (simboli i ngadalesisë) tërheq një dosje avash avash për ta sjellë të kerkuesi. Dosja megjithatë një ditë mberrin, ajo quhet se nuk ka ardhur kurrë (për atë kohë sa ishte i vlefshëm si informacion). Në këtë metafore, raporti solli shifra krahasuese me periudhat e mëparshme (vitet 2015, 2016, 2017), për të vënë re nëse ka përmirësime apo përkeqësime të treguesve. Në thelb të diskutimit u shtrua pikërisht vonësia në marrjen e informacionit, e cila dukshëm është shtuar gjatë vitit 2018. Afati i kthimit të përgjigjeve fillestare është rritur nga 13 në 26 ditë. Afati i reagimit



pas ankimit administrativ është rritur nga 13 në 25 dite. Vendimet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit merren për mesatarisht 54 dite. Nderkohe që cilësia e vendimeve të Komisionerit është e mirë, dinamika e trajtimit të rasteve ka lënë për të dëshiruar, duke sjelle si pasoje një relaksim të institucioneve kundër detyrimeve sipas ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Këto, por edhe gjetje të tjera që flasin për problematikat e vecanta, janë bërë pjesë e studimit të plotë, të cilin mund ta shkarkoni këtu.

---

## Raport i përmbledhur për zbatimin e ligjit për konsultimin publik 2017-2018



Me mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED), në kuadër të projektit “Promovimi i pjesëmarrjes qytetare në advokimin legjislativ”, Res Publica po vijon monitorimin e zbatimit të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Për periudhën e deritanishme, 2017 – 2018, po

publikojmë një raport të permbledhur, në të cilin analizohen të dhënat që janë mbledhur deri në këtë periudhë dhe disa nga indikatorët mbi të cilat do të mbështetet dhe përgatitja e studimit përfundimtar në Mars 2019. Për më shumë klikoni këtu për të shkarkuar raportin.

Situata deri tani shfaqet problematike. Organet publike janë ende larg zbatimit në mënyrë efektive të ligjit dhe akteve nënligjore. Në vija të përgjithshme konstatohet që Ministrinë nuk i plotësojnë tabelat për njoftimin dhe konsultimin publik të projektakteve. Ministrinë nuk hartojnë dhe nuk publikojnë raportet vjetore të transparencës. Konstatohet që Bashkitë kanë mungesë informacioni dhe nuk kuptojnë kush janë aktet që përfshihen dhe janë subjekt i ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik, duke demonstruar nevojë urgjente për trajnime në këtë fushë. Regjistri për Njoftimin dhe Konsultimin Publik është ende shumë larg funksionimit në mënyrë efektive, sepse nga njëra ana institucionet pothuaj nuk e përdorin këtë faqe dhe nga ana tjetër publiku nuk shfaq asnjë interes për këtë faqe.

Nga ana tjetër, cilësia e komenteve dhe rekomandimeve të ardhura nga publiku lë ende për të dëshiruar dhe pjesa më e madhe e grupeve të interesit nuk shfaqin rol aktiv në proceset vendimmarrëse edhe kur u jepet mundësia të marrin pjesë në to.

Të dhënat dhe gjetjet që do të rezultojnë në fund të këtij projekti, do të krahasohen me të dhënat e studimeve paraprake, me qëllim konstatimin se si organet publike zbatojnë detyrimet që rrjedhin nga ligji dhe sa efektiv është ky ligj në duart e qytetarëve, organizatave të shoqërisë civile, grupeve të interesit. Rekomandimet që do të dalin nga ky studim, do t'i vendosen në dispozicion institucioneve kompetente dhe aktorëve të fushës me qëllim marrjen e masave administrative si dhe për të bërë amendimet e nevojshme në ligj.

Res Publica

---

# **The Effectiveness of the Law on the Right to Information – 2017**

It is by now a tradition for Res Publica to evaluate the effectiveness of the law on the right to information at the end of each year. With the support of Civil Rights Defenders, the publication presents a critical picture of the law and its shortcomings. Theoretically, this law is ranked sixth in the world in terms of quality; however it does not have sufficient mechanisms to guarantee transparency from public authorities in case they deny requested information.

[Click here to read the full report.](#)

---

# **Efektiviteti i ligjit për të drejtën e informimit – 2017**

Tashme është bërë traditë që Res Publica në fund të çdo viti vlerëson efektivitetin e ligjit për të drejtën e informimit. Me mbështetjen e Civil Rights Defenders, sjellim një tablo kritike ndaj ligjit dhe mangësi të tij. Teorikisht ligji është renditur si i gjashti në botë për nga cilësia, por ky ligj nuk ka mekanizma të mjaftueshëm për të garantuar transparencën e autoriteteve publike kur ato nuk kanë vullnet të japin informacionet e kërkuara.

Per me shume klikoni ketu per te shkarkuar raportin.

Res Publica

---

## **Indeksi i transparencës 2017**

Prej kohesh Res Publica angazhohet fuqimisht ne mbrojtjen e nje prej te drejtave themelore ne nje shoqeri demokratike – te drejtes per informim.

Ne kuader te projektit “Rritja e aksesit të gazetarëve investigues në informacionin zyrtar” që mbështetet financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i

Ambasadës së SH.B.A.-së në Tiranë, Res Publica synon te sjelle nje tablo se si paraqitet transparenca e autoriteteve publike. Transparenca eshte vleresuar ne te dy aspektet, ate proaktive dhe ate reaktive.

Res Publica monitoroi 100 autoritetet publike më të rëndësishëm per permbushjen e programeve te transparences dhe vleresoi gjithashtu edhe sjelljen e institucioneve në rastin e trajtimit të kërkesave për informacion të dërguara nga qytetarët, gazetarët, aktivistët, etj. Janë dërguar gjithsej 515 kërkesa për informacion, prej të cilave 84 janë nga gazetarët investigues.

Ky aspekt është i një rëndësie të veçantë sepse një institucion mund të publikojë shumë informacione pa kërkesë, por nga ana tjetër mund të mos përgjigjet ndaj kërkesave specifike, çka mund të minojë transparencën.

Vleresimi u be ne menyre dinamike duke studiuar ndryshimet cdo muaj gjate periudhes Shtator 2016 – Qershor 2017. Rezultatet mujore jane publikuar ne faqen [www.publeaks.al](http://www.publeaks.al) dhe raporti i

permbledhur pasqyron gjetjet kryesore te periudhes, shoqeruar me rekomandimet perkatese. Per me shume klikoni ketu per te shkarkuar raportin.

Res Publica